

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditimi i avancuar dhe
siguria**

P10

Data 29/01/2022

Detyra 1

Klienti juaj, Ajova Shpk, është një prodhues i makinerive të përdorura në industrinë e prodhimit të energjisë. Aktualisht po planifikoni auditimin e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 30 nëntor 2020. Drafti i pasqyrave financiare tregojnë të ardhura prej 125 milionë dollarë (2019– 103 milionë dollarë), fitim para tatimit prej 5.6 milionë dollarë (2019 – 5.1 milionë dollarë) dhe asetet totale prej 95 milionë dollarë (2019 – 90 milionë dollarë). Firma juaj u emërua si auditore në Ajova Shpk për herë të parë në qershor 2020.

Ajova Shpk projektton, ndërton dhe instalon makineri për pesë klientët kryesorë. Pagesa paguhet në tre këste: 50% duhet të bëhet kur porosia konfirmohet (faza e parë), 25% me dorëzimin e makinerive (faza e dytë) dhe 25% për instalimin e suksesshëm në lokacionin e klientit (faza e tretë). Në përgjithësi duhen gjashtë muaj nga përfundimi i porosisë deri në instalimin përfundimtar.

Më 30 nëntor, ka një shumë të papaguar prej 2.85 milionë dollarësh nga KosEnero. Shuma është një pagesë e diskutueshme e fazës së tretë. KosEnergo po refuzon të paguajë derisa makineria, e cila u instalua në gusht 2020, të funksionojë me efikasitet 100%.

Një klient, Sajonara, komunikoi në nëntor 2020, nëpërmjet avokatëve të tij me Ajova Shpk, duke kërkuar dëmshpërblim për dëmtimet e pësuar nga një operator i kompanisë kur, krahu i të cilit u plagos rëndë kur një makinë nuk funksionoi. Kaqusha, drejtore ekzekutive e Ajova Shpk, ju ka thënë se pretendimi po injorohet pasi dihet përgjithësisht se Sajonara ka një histori të dobët shëndetësore dhe sigurie, dhe kështu aksidenti ishte faji i tyre. Dy porosi të cilat ishin vendosur nga Sajonara në tetor 2020 janë anuluar.

Puna në proces vlerësohet në 8.5 milion dollarë më 30 nëntor 2020. Një numërim fizik i stoqeve u mbajt më 17 nëntor 2020. Kryeinxhinieri vlerësoi fazën e përfundimit të secilës makinë në atë datë. Një nga komponentët kryesorë të përfshirë në makinerinë e prodhimit të energjisë tani po merret nga jashtë. Furnizuesi i ri, Look Co, ndodhet në Spanjë dhe faturon Ajova Shpk në Euro. Ekziston një llogarie e pagueshme prej 1.5 milion dollarë për shkak të Look Co, e regjistruar brenda detyrimeve afatshkurta.

Të gjitha makineritë furnizohen me një garanci një vjeçare. Një provizion garancie njihet në pasqyrën e pozicionit prej 2.5 milion dollarë (2019 – 2.4 milion dollarë). Kaqusha vlerëson koston e riparimit të makinerive me defekt të raportuar nga klientët dhe ky vlerësim përbën bazën e provizionit të njohur në pasqyra.

Kaqusha zotëron 60% të aksioneve në Ajova Shpk. Ajo gjithashtu zotëron 55% të Texas Shp, e cila i jep me qira një zyrë qendrore Ajova Shpk. Kaqusha po konsideron të shesë disa nga aksionet e saj në Ajova Shpk në fund të janarit 2021 dhe do të dëshironte që auditimi të përfundojë deri në atë kohë.

Kërkohet:

(a) Duke përdorur informacionin e dhënë, identifikoni dhe shpjegoni rreziqet kryesore të auditimit dhe çdo çështje tjetër që duhet të merret parasysh gjatë planifikimit të auditimit përfundimtar për Ajova Shpk për vitin e përfunduar më 30 nëntor 2020.

Shënim: përgjigja juaj duhet të paraqitet në formatin e shënimeve informuese që do të përdoren në një takim planifikimi. Kërkesa (a) përfshin 2 pikë profesionale. (13 pikë)

(b) Shpjegoni procedurat kryesore të auditimit që do të kryhen gjatë auditimit përfundimtar në lidhje me provizionin e parashikuar të garancisë në pasqyrën e pozicionit financiar së Ajova Shpk më 30 nëntor 2020. (5 pikë)

(c) (i) Identifikoni dhe përshkruani KATËR procedura të kontrollit të cilësisë që janë të zbatueshme për angazhimin individual të auditimit; dhe (8 pikë)

(ii) Diskutoni DY probleme që mund të ndeshen në zbatimin e procedurave të kontrollit të cilësisë në një firmë të vogël të auditimit dhe rekomandoni se si mund të kapërcehen këto probleme. (4 pikë)

[Gjithsej: 30 pikë]

Zgjidhja

Njohja e të hyrave – koha

Ajova Shpk lëshon faturat e shitjes në tre faza. Ekziston mundësia për shkelje të SNRF 15 Të hyrat nga kontrata me konsumator, i cili thotë se të hyrat duhet të njihen vetëm pasi mallrat apo shërbimet janë transferuar te blerësi, me fjalë të tjera shitësi ka përmbushur detyrimet e tij kontraktuale. Kjo e drejtë nuk korrespondon domosdoshmërisht me shumat që duhet të paguhen në përputhje me një plan fature të rënë dakord me një klient si pjesë e një kontrate. Ajova Shpk duket se merr pagesa nga klientët e saj përpara kryerjes së çdo detyrimi, pasi fatura në fazën e parë lëshohet kur një porosi konfirmohet, pra përpara se të ketë kryer ndonjë punë. Kjo krijon mundësinë që të ardhurat të njihen shumë herët, përpara çdo përmbushjeje të detyrimit kontraktual. Kur një pagesë merret përpara përmbushjes, duhet të njihet një detyrim i barabartë me shumën e marrë, që përfaqëson detyrimin sipas kontratës. Prandaj një rrezik i rëndësishëm është që të ardhurat të mbivlerësohen dhe detyrimet të nënvlerësohen.

Të arkëtueshme të kontestuara

Shuma e borxhit nga KosEnergo është shumë materiale pasi përfaqëson 50.9% të fitimit para tatimit, 2.3% të të ardhurave dhe 3% të totalit të pasurive. Rreziku është që të arkëtueshmet të mbivlerësohen nëse nuk njihet provizioni i të arkëtueshmeve të kontestuara.

Pretendimi ligjor

Pretendimi duhet të hetohet seriozisht nga Ajova Shpk. Mendimi i Drejtorit Ekzekutiv (DE) se pretendimi nuk do të sjellë ndonjë pasojë financiare për Ajova Shpk, është naiv dhe i kotë. Ajova Shpk mund t'i jepet dëmshpërblim nëse konstatohet se makineria është me defekt. Niveli i lartë i përsëritur i provizionit të garancisë nënkupton që defektet e makinerisë janë mjaft të zakonshme dhe për këtë arsye aksidenti mund të jetë rezultat i një makine me defekt që i është furnizuar Sajonara. Rreziku është që të mos krijohet asnjë provizion për dëmet e mundshme sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente, nëse mundësia për të paguar dëmet konsiderohet e mundshme. Përndryshe, nëse gjasat për t'i paguar dëmet Sajonara konsiderohet një mundësi, atëherë duhet të bëhet një shpalosje në pasqyrat financiare që përshkruan natyrën dhe efektin e mundshëm financiar të detyrimit kontingjent. Siç diskutohet më poshtë, DE, Kaqusha, ka një nxitje që të mos bëjë një provizion ose të zbulojë një detyrim kontingjent për shkak të shitjes së planifikuar të aksioneve pas fundit të vitit.

Një rrezik i mëtejshëm është se çdo tarifë ligjore e lidhur me pretendimin nuk është paraqitur si një akruale brenda pasqyrave financiare. Meqenëse kërkesa ka lindur gjatë vitit, shpenzimi duhet të përfshihet në pasqyrën e të ardhurave të këtij viti, edhe nëse kërkesa është ende në vazhdim në fund të vitit.

Fakti që pretendimi ligjor është duke u injoruar efektivisht mund të ngrejë dyshime mbi integritetin e përgjithshëm të menaxhmentit të lartë dhe mbi integritetin e pasqyrave financiare. Përfaqësimet e menaxhmentit duhet të trajtohen me një shkallë skepticismi profesional gjatë auditimit.

Sajonara ka anuluar dy porosi. Nëse shumat janë ende të papaguara në fund të vitit, atëherë ka shumë gjasë që Sajonara të mos paguajë shumat e faturuara, dhe kështu të arkëtueshmet janë të mbivlerësuar. Nëse pagesat e fazës së parë janë bërë tashmë, atëherë Sajonara mund të kërkojë një rimbursim, në të cilin rast duhet të bëhet një provizion për të shlyer shumën, ose një detyrim kontingjent i shpalosur në një shënim të pasqyrave financiare.

Sajonara është një nga vetëm pesë klientët kryesorë dhe humbja e këtij klienti mund të ketë pasoja në vijimësi për Ajova Shpk nëse nuk mund të gjendet një burim i ri të ardhurash për të zëvendësuar rrjedhën e humbur të të ardhurave nga Sajonara. Nëse pretendimi ligjor bëhet i ditur publikisht, dhe nëse Ajova Shpk konstatohet se ka furnizuar makineri me defekte, atëherë do të jetë e vështirë të tërheqësh klientë të rinj.

Një rast i kësaj natyre mund të sjellë një publicitet të keq për Ajova Shpk, një çështje e mundshme me hipotezën e vijimësisë nëse rezulton në ndërprerjen e porosive nga ndonjë nga pesë klientët kryesorë me Ajova Shpk. Auditorët duhet të planifikojnë të zgjerojnë programin e punës për vijimësinë për të përfshirë çështjet e përmendura më sipër.

Stoqet

Puna në proces është materiale për pasqyrat financiare, duke përfaqësuar 8.9% të totalit të pasurive. Numërimi i stoqeve mbajt dy javë para fundit të vitit. Ekziston një rrezik i natyrshëm që vlerësimi të mos jetë bartur saktë në pozicionin e fundit të vitit.

Rreziku kryesor është vlerësimi i fazës së përfundimit të punës në proces. Kjo është subjektive dhe njohuritë duket se janë të kufizuara tek inxhinieri kryesor. Stoqet mund të mbivlerësohen nëse makineritë vlerësohen të jenë më të kompletuara se sa janë në fakt në fund të vitit. Absorbimi i kostove të punës dhe shpenzimeve të përgjithshme në çdo makinë është një llogaritje komplekse dhe duhet të bëhet në përputhje me atë të mëparshme.

Do të jetë gjithashtu e rëndësishme që stoqet e konsumueshme që nuk janë përdorur ende në një makinë, p.sh. vidhat, dadot dhe bulonat, vlerësohen saktë dhe përfshihen si stoqe të lëndëve të para brenda pasurive qarkulluese.

Furnizuesit jashtë shtetit

Duke qenë se furnizuesi është i ri, kontrollet mund të mos jenë vendosur ende mbi regjistrimin e transaksioneve në valutë. Rreziku i vetëvetishëm është i lartë pasi llogaria e pagueshme duhet të ripërkthehet duke përdorur kursin e këmbimit në fund të vitit sipas SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor. Nëse ripërkthimi nuk kryhet në fund të vitit, llogaria e pagueshme mund të jetë dukshëm e mbi ose nënvlerësuar, në varësi të lëvizjes së kursit të këmbimit të dollarit në euro midis datës së blerjes dhe fundit të vitit. Komponentët duhet të mbeten me kosto historike brenda vlerësimit të stoqeve dhe nuk duhet të ripërkthehen në fund të vitit.

Provizioni i garancisë

Provizioni i garancisë është material në 2.6% të totalit të pasurive (2019 – 2.7%). Provizionin është rritur me vetëm 100,000 dollarë, një rritje prej 4.2%, krahasuar me një rritje të të ardhurave prej 21.4%. Kjo mund të tregojë një nënprovizion pasi ndryshimi në përqindje në të ardhurat pritet të jetë në përputhje me ndryshimin në përqindje në provizionin e garancisë, përveç nëse janë bërë përmirësime të rëndësishme në cilësinë e makinerive të instaluar për klientët gjatë vitit. Kjo duket e pamundur duke pasur parasysh pretendimin ligjor nga Sajonara, dhe makinat e instaluar në KosEnergo që funksionojnë në mënyrë joefikase. Baza e vlerësimit mund të nënvlerësohet për të shmangur ngarkimin e rritjes së provizionit si shpenzim përmes pasqyrës së të ardhurave. Kjo është një shqetësim i veçantë duke qenë se është DE është aksionar shumicë dhe që vlerëson provizionin e garancisë.

Aksionari shumicë

Kaqusha ushtron kontrollin mbi Ajova Shpk nëpërmjet shumicës së aksioneve dhe duke mbajtur postin e DE. Kjo rrit në masë të madhe rrezikun e vetëvetishëm që pasqyrat financiare mund të keqdeklarohen qëllimisht, d.m.th., mbivlerësimi i pasurive, nënvlerësimi i detyrimeve, dhe rrjedhimisht mbivlerësimi i fitimeve. Rreziku është i madh në fund të këtij viti pasi Kaqusha shpreson të shesë disa aksione të Ajova Shpk pas fundit të vitit. Duke qenë se çmimi që ajo merr për këto aksione do të ndikohet në një masë të madhe nga pozicioni financiar i kompanisë më 30 nëntor 2020, ajo ka një interes të caktuar për të manipuluar pasqyrat financiare për përfitimin e saj personal. Për shembull:

- Mosnjohja e një provizioni ose detyrimi kontingjent për pretendimin ligjor nga Sajonara
- Mos provizionimi i të arkëtueshmeve potencialisht të pakthyeshme nga KosEnergo
- Mos rritja e provizionit të garancisë
- Njohja e të ardhurave më herët se sa lejohet nga SNRF 15.

Transaksionet me palët e lidhura

Kaqusha kontrollon Ajova Shpk dhe gjithashtu kontrollon Pacific Co. Transaksionet ndërmjet dy kompanive duhet të shpalosen sipas SNK 24 Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura. Ekziston rreziku që jo të gjitha transaksionet të jenë shpalosur, ose që një transaksion të jetë shpalosur me një vlerë të papërshtatshme. Detajet e kontratës së qirasë ndërmjet dy kompanive duhet të bëhen të ditura brenda një shënimi në pasqyrat financiare, në veçanti, çdo shumë që i detyrohet Ajova Shpk ndaj Texas Shpk në 30 nëntor 2020 duhet të shpaloset.

Çështje të tjera

- Kaqusha dëshiron që auditimi të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, gjë që sjell përpara afatin e përfundimit të auditimit. Ekipi i auditimit mund të mos ketë kohë për të përfunduar të gjitha procedurat e nevojshme, ose mund të mos ketë kohë që të kryhen rishikime adekuate për punën e kryer. Rreziku i zbulimit dhe rrjedhimisht rreziku i auditimit rritet dhe cilësia e përgjithshme e auditimit mund të rrezikohet.
- Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke pasur parasysh se ky është viti i parë i auditimit dhe për këtë arsye ekipi i auditimit do të punojë me një kurbë të pjerrët mësimore. Procedurat e auditimit mund të zgjasin më shumë se sa ishte planifikuar fillimisht, megjithatë ka pak kohë për të zgatur procedurat aty ku është e nevojshme.
- Kaqusha gjithashtu mund të ushtrojë ndikim të konsiderueshëm tek anëtarët e grupit të auditimit për të siguruar që pasqyrat financiare të tregojnë pozicionin më të mirë të mundshëm të Ajova Shpk në funksion të shitjes së aksioneve të saj. Është thelbësore që anëtarët e ekipit të auditimit t'u përmbahen rreptësisht udhëzimeve etike dhe se pavarësia është e padiskutueshme.
- Për shkak të seriozitetit të çështjeve të përmendura më lart, një çështje përfundimtare që duhet marrë në konsideratë në fazën e planifikimit është që një rishikim i dytë i partnerit (Rishikimi i Kontrollit të Cilësisë së Angazhimit) duhet të konsiderohet për auditimin në fund të këtij viti. Një rishikues i pavarur i përshtatshëm duhet të identifikohet dhe koha të planifikohet dhe të buxhetohet në fund të angazhimit.

Konkluzioni

Nga gama e çështjeve të diskutuara në këto shënime, shihet se auditimi i Ajova Shpk do të jetë një angazhim relativisht me rrezikshmëri të lartë.

(b) ISA 540 Auditimi i Vlerësimeve Kontabël kërkon që auditorët duhet të përftojnë dëshmi të mjaftueshme auditimi nëse një vlerësim kontabël, si p.sh. një provizion garancie, është i

arsyeshëm duke pasur parasysh rrethanat e kompanisë dhe se shpalosja është e përshtatshme. Duhet të përdoret një ose një kombinim i qasjeve të mëposhtme:

- Rishikoni dhe testoni procesin e përdorur nga menaxhmenti për të zhvilluar vlerësimin
- Rishikoni kontratat ose porositë për kushtet e garancisë për të kuptuar detyrimin e Ajova Shpk
- Rishikoni korrespondencën me klientët gjatë vitit për të kuptuar pretendimet tashmë në vazhdim në fund të vitit
- Kryeni procedura analitike për të krahasuar nivelin e ofrimit të garancisë nga viti në vit, dhe krahasuar provizionet aktuale me ato të buxhetuara. Nëse është e mundur, ndani të dhënat, për shembull, krahasoni provizionet për lloje të veçanta makinerish ose klient për klientit
- Rillogaritni provizionin e garancisë
- Përputhni përqindjen e aplikuar me llogaritjen e politikës kontabël të deklaruar të Ajova Shpk
- Rishikoni procesverbalet e bordit për diskutimin e pretendimeve të vazhdueshme të garancisë dhe për miratimin e shumës së dhënë
- Përdorni pasqyrat meanxheriale për të përcaktuar nivelin normal të kostove të korigjimit të garancisë gjatë vitit
- Diskutoni me DE supozimet që ajo përdori për të përcaktuar përqindjen e përdorur në llogaritjet e saj
- Merrni parasysh nëse supozimet e përdorura janë në përputhje me të kuptuarit e auditorëve për biznesin
- Krahasoni provizionet e vitit të kaluar me shpenzimet aktuale për pretendimet e garancisë në periudhën kontabël
- Krahasoni provizionin e vitit aktual me vitin e kaluar dhe diskutoni çdo lufatje me DE.
- Rishikoni ngjarjet pasuese të cilat konfirmojnë vlerësimin e bërë
- Rishikoni çdo punë të kryer pas fundit të vitit për defekte specifike që janë parashikuar. Sigurohuni që të gjitha kostot të përfshihen në provizionin e fundit të vitit.
- Përputhni paratë e gatshme të shpenzuara për punën e korigjimit në periudhën e pas bilancit në librin e parasë
- Përputhni paratë e shpenzuara për punën e korigjimit pas fundit të vitit për faturat e furnitorëve, ose në regjistrat e brendshëm të kostos nëse puna kryhet nga punonjësit e Ajova Shpk.
- Lexoni korrespondencën e klientit të marrë pas fundit të vitit për çdo pretendim të marrë që nga fundi i vitit.

(c) (i) ISQC 1 Kontrolli i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të informacionit historik financiar, ofron udhëzime mbi sistemet e përgjithshme të kontrollit të cilësisë që duhet të zbatohen nga një firmë auditimi. SNA 220 Kontrolli i Cilësisë për Auditimet e Pasqyrave Financiare specifikon procedurat e kontrollit të cilësisë që duhet të zbatohen nga ekipi i angazhimit në detyrat individuale të auditimit.

Procedurat përfshijnë si më poshtë:

Procedurat e pranimit të klientit

Duhet të ketë dokumentacion të plotë dhe konkluzione mbi çështjet etike dhe të pranimit të klientit në çdo detyrë auditimi.

Partneri i angazhimit duhet të marrë parasysh nëse anëtarët e ekipit të auditimit kanë përmbushur kërkesat etike, për shembull, nëse të gjithë anëtarët e ekipit janë të pavarur nga

klienti. Për më tepër, partneri i angazhimit duhet të konkludojë nëse të gjitha procedurat e pranimit janë ndjekur, për shembull, se firma e auditimit ka marrë parasysh integritetin e pronarëve kryesorë dhe menaxhmentit kryesor të klientit. Procedurat e tjera për pranimin e klientit duhet të përfshijnë:

- Komunikimi me auditorët e mëparshëm
- Shqyrtimi i çdo konflikti interesi
- Procedurat e pastrimit të parave (identifikimi i klientit).

Ekipi i angazhimit

Procedurat duhet të ndiqen për të siguruar që ekipi i angazhimit së bashku të ketë aftësitë, kompetencën dhe kohën për të kryer angazhimin e auditimit. Partneri i angazhimit duhet të vlerësojë se ekipi i auditimit, për shembull:

- Ka nivelin e duhur të njohurive teknike
- Ka përvojë në angazhime auditimi të natyrës dhe kompleksitetit të ngjashëm
- Ka aftësi për të zbatuar gjykimin profesional
- Kupton standardet profesionale, kërkesat rregullatore dhe ligjore.

Drejtimi

Ekipi i angazhimit duhet të drejtohet nga partneri i angazhimit. Duhet të ndërmerren procedura të tilla si një takim i planifikimit të angazhimit për të siguruar që ekipi të kuptojë:

- Përgjegjësitë e tyre
- Objektivat e punës që duhet të kryejnë
- Natyra e biznesit të klientit
- Çështjet që lidhen me rrezikun
- Si të merreni me çdo problem që mund të lindë; dhe
- Qasja e detajuar për kryerjen e auditimit.

Takimi i planifikimit duhet të udhëhiqet nga partneri dhe duhet të përfshijë të gjithë personat e përfshirë në auditim. Duhet të ketë një diskutim të çështjeve kryesore të identifikuara në fazën e planifikimit.

Mbikëqyrja

Mbikëqyrja duhet të jetë e vazhdueshme gjatë angazhimit. Çdo problem që lind gjatë auditimit duhet të korrigjohet sa më shpejt që të jetë e mundur. Vëmendja duhet të përqendrohet në sigurimin që anëtarët e ekipit të auditimit po e kryejnë punën e tyre në përputhje me qasjen e planifikuar ndaj angazhimit. Çështjet e rëndësishme duhet t'u vihen në vëmendje anëtarëve të lartë të ekipit të auditimit. Dokumentacioni duhet të bëhet për vendimet kryesore të bëra gjatë angazhimit të auditimit.

Rishikimi

Procesi i rishikimit është një nga procedurat kryesore të kontrollit të cilësisë. E gjithë puna e kryer duhet të rishikohet nga një anëtar më i lartë i ekipit të auditimit. Rishikuesit duhet të marrin parasysh për shembull nëse:

- Puna është kryer në përputhje me standardet profesionale
- Objektivat e procedurave të kryera janë arritur
- Puna mbështet konkluzionet e nxjerra dhe është e dokumentuar siç duhet.

Vetë procesi i rishikimit duhet të dokumentohet.

Konsultimi

Së fundi, partneri i angazhimit duhet të organizojë konsultime për çështje të vështira ose të diskutueshme. Kjo është një procedurë ku çështja diskutohet me një profesionist jashtë ekipit të angazhimit, dhe ndonjëherë edhe jashtë firmës së auditimit. Konsultimet duhet të dokumentohen për të treguar:

- Çështja për të cilën është kërkuar konsultimi; dhe
- Rezultatet e konsultimit.

(ii) Konsultimi – mund të mos jetë e mundur të zhvillohen konsultime të gjera për çështje të specializuara brenda një firme të vogël, për shkak të mungesës së profesionistëve të specializuar. Mund të mungojnë kolegët me përvojë të përshtatshme për të diskutuar çështjet që dalin nga angazhimet e klientëve. Mund të jenë të nevojshme marrëveshje me firma të tjera për konsultim.

Trajnimi/Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP) – burimet mund të mos jenë të disponueshme dhe është e shtrenjtë të krijohet një funksion trajnimi brenda firmës. Konsorciumet e trajnimit të jashtëm mund të përdoren për të ofruar trajnime/EVP për staf të kualifikuar dhe trajnim për çështje që nuk lidhen me provimet për personelin e pakualifikuar.

Procedurat e rishikimit – mund të mos jetë e mundur të bëhet një rishikim i pavarur i një angazhimi brenda firmës për shkak të numrit të vogël të auditorëve të vjetër dhe me përvojë. Në këtë rast mund të blihet një shërbim rishikimi i jashtëm.

Mungesa e përvojës specialistike – ku nevojiten aftësi të veçanta në kuadër të një angazhimi; aftësitë mund të blihen, për shembull, duke dërguar personel nga një praktikë tjetër. Përndryshe, nëse puna është shumë e specializuar për firmën, puna mund të nënkontraktohet në një firmë tjetër.

Dokumentet e punës – firmës mund t'i mungojnë burimet për të krijuar një grup të brendshëm manualesh auditimi ose letra standarde pune.

Në këtë rast dokumentacioni mund të sigurohet nga firma të jashtme ose organizata profesionale.

Detyra 2

Ju jeni menaxheri i auditimit për tre klientë të Llapi Audit, një firmë e auditimit. Fundi i vitit financiar për çdo klient është 30 shtator 2020.

Ju jeni duke rishikuar raportet e propozuara të auditimit nga seniorët e auditimit për dy klientë, Alfa ShA dhe Beta Shpk.

Alfa ShA, një kompani e listuar, mbylli përgjithmonë disa fabrika në maj 2020, me të gjitha kostot e mbylljes së përfunduar dhe paguar në gusht 2020. Të gjitha fabrikat prodhonin të njëjtin artikull, i cili kontribuoi me 10% të të hyrave totale të Alfa për vitin që përfundon më 30 shtator 2020 (2019 – 23%). Mbyllja është diskutuar saktë dhe plotësisht në deklaratën e kryetarit dhe në raportin e drejtorëve. Megjithatë, mbyllja nuk është përmendur në shënimet e pasqyrave financiare dhe as nuk është shpalosur veçmas në pasqyrat financiare.

Seniori i auditimit ka propozuar një opinion të pamodifikuar auditimi për Alfa ShA pasi çështja është adresuar plotësisht në deklaratën e kryetarit dhe në raportin e drejtorëve.

Në tetor 2020 u ngrit një kërkesë ligjore kundër Beta, një shitës me pakicë lodrash. Pretendimi është nga një klient i cili rrëshqiti në një shkallë të yndyrshme jashtë një prej pikave të shitjes me pakicë. Çështja është shpalosur plotësisht si një detyrim material kontingjent në shënimet e pasqyrave financiare dhe letrat e punës së auditimit ofrojnë dëshmi të mjaftueshme që nuk është e nevojshme asnjë provizion pasi avokatët e Beta kanë deklaruar me shkrim se gjasat që kërkesa të ketë sukses është vetëm e mundur.

Shuma e kërkesës është fikse dhe mbulohet në mënyrë të mjaftueshme nga burimet e parave të gatshme.

Seniori i auditimit propozon që opinionin e auditimit për Beta të mos jetë i kualifikuar, por të përfshihet një paragrafi i theksimit të çështjes pas opinionit të auditimit për të nxjerrë në pah situatën.

Hona Shpk u themelua në tetor 2019, duke përdorur një kredi bankare për financim. Të hyrat për vitin e parë të tregtimit janë 750,000 Euro dhe ka shpresa për rritje të shpejtë në vitet e ardhshme. Biznesi tregton me pakicë lodra luksoze prej druri të punuar me dorë, aktualisht në një pikë të vetme. Dy drejtorët (të cilët zotërojnë gjithashtu të gjitha aksionet në Hona Shpk) janë të vetëdijshëm se për shkak të madhësisë së vogël të kompanisë, pasqyrat financiare nuk duhet t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm vjetor, por ata nuk janë të sigurt nëse do të ketë ndonjë përfitim nga auditimi vullnetar i pasqyrave financiare të vitit të parë. Drejtorët janë gjithashtu të vetëdijshëm se një rishikim i pasqyrave financiare mund të kryhet si një alternativë ndaj një auditimi të plotë.

Hona Shpk aktualisht punëson një kontabilist me kohë të pjesshme, që është në certifikim e sipër, i cili ka përgatitur një pasqyrë të pozicionit financiar në fund të vitit dhe pasqyrën e të ardhurave, dhe i cili prodhon pasqyrat përmbledhëse të menaxhimentit çdo tre muaj.

Kërkohet:

(a) Vlerësoni nëse raporti i auditimit i propozuar nga seniori i auditimit është i përshtatshëm dhe ku nuk jeni dakord me raportin e propozuar, rekomandoni ndryshimin e nevojshëm në raportin e auditimit të:

(i) Alfa ShA; (6 pikë)

(ii) Beta Shpk. (4 pikë)

(b) Përshkruani përfitimet e mundshme për Hona Shpk nëse zgjedhin të auditojnë pasqyrat financiare. (4 pikë)

(c) Me referencë specifike për Hona Shpk, diskutoni objektivin e një angazhimi të rishikimit dhe bëni dallime nga niveli i sigurinë e dhënë me atë të dhënë në një auditim të pasqyrave financiare. (6 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

(a) (i) Alfa

Mbylljet e fabrikës përbëjnë një operacion të ndërprerë sipas SNRF 5 Pasuritë joqarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera, për shkak të ndërprerjes së një komponenti kryesor të veçantë të biznesit. Është një komponent kryesor për shkak të kontributit prej 10% në të ardhurat në vitin deri më 30 shtator 2020 dhe 23% kontributit në 2019. Është një komponent i veçantë biznesi i kompanisë për shkak se fabrikat kanë bërë vetëm një artikull, që tregon një njësi gjeneruese për të ardhura të veçanta.

Sipas SNRF 5 duhet të ketë shpalosje të veçantë në pasqyrën e të ardhurave dhe rezultateve pas tatimit të operacionit të ndërprerë dhe të çdo fitimi ose humbjeje që rezulton nga mbylljet. Të ardhurat dhe kostot e operacionit të ndërprerë duhet të shpalosen veçmas ose në pasqyrën e të ardhurave ose në shënimet e pasqyrave financiare. Rrjedhat e parasë së gatshme që lidhen me operacionin e ndërprerë duhet gjithashtu të shpalosen veçmas sipas SNK 7 Pasqyrat e rrjedhës së parasë.

Përveç kësaj, duke qenë se Alfa është një kompani e listuar, SNRF 8 Segmentet Operative kërkon shpalosje segmentale të veçanta të operacioneve të ndërprera.

Dështimi për të shpalosur informacionin e mësipërm në pasqyrat financiare është një shkelje materiale e SNRF dhe Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Prandaj, opinioni i auditimit duhet të kualifikohet në bazë të mosmarrëveshjes për shpjosjet (SNRF 5, SNK 7 dhe SNRF 8). Çështja është materiale, por jo e përhapur, dhe për këtë arsye duhet të lëshohet një opinion 'përveç për'.

Paragrafi i opinionit duhet të tregojë qartë arsyen e mosmarrëveshjes dhe një tregues të rëndësisë financiare të çështjes.

Opinionin e auditimit lidhet vetëm me pasqyrat financiare që janë audituar, dhe përmbajtja e informacionit tjetër (deklarata e kryetarit dhe raporti i drejtorëve) është i parëndësishëm kur vendoset nëse pasqyrat financiare tregojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë, apo janë paraqitur në mënyrë të drejtë.

Shënim udhëzues: nuk ka asnjë tregues në skenarin e pyetjes që Alfa është në vështirësi financiare ose operacionale, prandaj nuk jepen nota për diskutime të parëndësishme të çështjeve të vazhdimësisë dhe ndikimit rezultues në opinionin e auditimit.

(ii) Beta

Kërkesa është një ngjarje pas datës së raportimit. Nëse aksidenti ka ndodhur para fundit të vitit 30 shtator 2020, pretendimi jep dëshmi shtesë të një kushti në fund të vitit, dhe kështu plotëson përkufizimin e një ngjarjeje korrigjuese të pas raportimit. Në këtë rast, çështja duket se është shpalosur siç duhet në shënimet e pasqyrave financiare sipas SNK 10 Ngjarjet pas periudhës së raportimit dhe SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente. Një provision do të ishte i nevojshëm vetëm nëse pretendimi ka gjasë të ketë sukses dhe ka dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme që nuk është kështu. Prandaj, nuk ka asnjë mosmarrëveshje dhe asnjë kufizim në fushëveprim.

Prandaj seniori ka të drejtë të propozojë një opinion të pakualifikuar.

Megjithatë, nuk është e nevojshme që raporti i auditimit të përmbajë paragrafin e theksimit të çështjes.

SNA 701 Modifikimet në Raportin e Auditorit të Pavarur thekson se një paragrafi i theksimit të çështjes duhet të përdoret për të nënvizuar një çështje ku ka pasiguri të konsiderueshme.

- Një pasiguri në lidhje me rezultatin e ardhshëm të çështjeve gjyqësore të jashtëzakonshme ose veprimeve rregullatore.
- Zbatimi i hershëm (aty ku lejohet) i një standardi të ri kontabël (për shembull, një Standard i ri Ndërkombëtar i Raportimit Financiar) që ka një efekt të përhapur në pasqyrat financiare përpara datës së hyrjes në fuqi.
- Një katastrofë e madhe që ka pasur ose vazhdon të ketë një efekt të rëndësishëm në pozicionin financiar të kompanisë

Ky nuk është rasti këtu pasi ka para të mjaftueshme për të paguar dëmet në rast të pamundur që kërkesa të shkojë kundër Beta. Kjo duket të jetë një situatë e njëhershme me një rrezik të ulët që dhe kështu nuk ka pasiguri të rëndësishme.

(b) Ka disa përfitime për Hona në zgjedhjen e një auditimi vullnetar të pasqyrave financiare.

Një auditim vjetor do të sigurojë që çdo anomali materiale e bërë nga kontabilisti pjesërisht i kualifikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare të fundvitit do të zbulohet. Kjo është e rëndësishme pasi drejtorët do të përdorin pasqyrat e fundvitit për të rishikuar progresin e tyre në vitin e parë të tregtimit dhe do të kenë nevojë për shifra të besueshme për të vlerësuar performancën. Një auditim do t'u japë drejtorëve rehati se pasqyrat financiare janë një bazë e shëndoshë për marrjen e vendimeve të biznesit.

Shifrat e sakta të vitit të parë do të mundësojnë gjithashtu buxhetim dhe parashikim më efektiv, gjë që do të jetë vendimtare nëse do të arrihet një rritje e shpejtë.

Auditorët ka gjasë të përdorin pasqyrat tremujore të menaxhmentit si pjesë e procedurave normale të auditimit. Auditorët do të jenë në gjendje të këshillojnë kontabilistin për çdo përmirësim që mund të bëhet në pasqyrat e menaxhmentit, për shembull, niveli i rritur i detajeve, raportimi më i shpeshtë. Pasqyra më cilësore meanxheriale do të ndihmojnë në drejtimin e përditshëm të biznesit dhe do të mundësojnë një përgjigje më të shpejtë ndaj çdo problemi që lind gjatë vitit.

Si një nënprodukt i auditimit, do të përgatitet një letër menaxhmenti (raport për personat e ngarkuar me qeverisjen), duke identifikuar dobësitë dhe duke bërë rekomandime për fusha të tilla si sistemet dhe kontrollet që do të përmirësojnë drejtimin e biznesit.

Ka gjasë që Hona do të kërkojë më shumë fonde bankare në mënyrë që të zgjerohet, dhe ka gjasë që banka do të donte të shihte shifrat e audituara për rishikim, përpara se të vendoste për financimin e mëtejshëm. Do të jetë më e lehtë dhe potencialisht më e lirë për të përfunduar financim nga ofruesit e tjerë me një set të audituar të pasqyrave financiare.

Meqenëse biznesi merret me shitje me para në dorë dhe tregton me pakicë sende të vogla luksoze, ekziston një rrezik i lartë i vjedhjes së aseteve. Auditimi i jashtëm mund të veprojë si një kontroll parandalues dhe zbulues, duke reduktuar kështu rrezikun e mashtrimit dhe ndikimin e dëmshëm që rezulton në pasqyrat financiare.

Pasqyrat e sakta financiare do të jenë baza më e mirë për vlerësimin e taksave dhe planifikimin tatimor. Një opinion auditimi do të rrisë besueshmërinë e shifrave.

Nëse biznesi rritet me shpejtësi, atëherë ka gjasë që në një moment në të ardhmen, kufiri i përjashtimit nga auditimi të tejkalohet dhe kështu një auditim të bëhet i detyrueshëm.

Zgjedhja për të kryer një auditim që nga viti i parë i themelimit do të reduktojë gabimet e mundshme të bartura në periudhat pasuese dhe kështu do të shmangë kualifikimet e saldove të hapjes.

(c) Objektivi i një angazhimi për rishikim është t'i mundësojë auditorit të përftoj një siguri mesatare nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me një kornizë të identifikuar të raportimit financiar. Kjo është përcaktuar në ISRE 2400 Angazhimet për Rishikimin e Pasqyrave Financiare.

Për të marrë këtë siguri, është e nevojshme të mblidhen dëshmi duke përdorur procedura analitike dhe pyetje me menaxhmentin. Procedurat thelbësore të detajuara nuk do të kryhen nëse auditori nuk ka arsye të besojë se informacioni mund të përmbajë anomali materiale.

Auditori duhet t'i qaset angazhimit me një shkallë të lartë skepticismi profesional, duke kërkuar rrethana që mund të shkaktojnë keqdeklarim të pasqyrave financiare. Për shembull, në Hona, fakti që përgatitësi i pasqyrave financiare është pjesërisht i kualifikuar, mund ta bëjë auditorin të besojë se ekziston një rrezik i lartë i vetëvetishëm që shifrat të jenë të gabuara.

Si rezultat i procedurave të kryera, objektivi i auditorit është të sigurojë një shprehje të qartë me shkrim të sigurisë së kufizuar në pasqyrat financiare. Në një angazhim rishikimi, audituesi do të deklaronte se 'ne nuk jemi në dijeni të ndonjë modifikimi material që duhet të bëhet në pasqyrat financiare....'

Kjo zakonisht referohet si një opinion i "sigurisë së kufizuar".

Siguria e kufizuar do të thotë që auditori ka kryer procedura të kufizuara dhe ka arritur në përfundimin se pasqyrat financiare duken të arsyeshme. Përdoruesi i pasqyrave financiare fiton njëfarë rehatie që shifrat i janë nënshtruar rishikimit, por ofrohet vetëm një nivel i moderuar sigurie. Përdoruesit mund t'i duhet të kryejë vetë procedura shtesë nëse dëshiron të mbështetet në pasqyrat financiare. Për shembull, nëse Hona do të përdorte pasqyrat financiare si një mjet për të përfutur financime të mëtejshme bankare, banka me sa duket do të kryente, ose do të kërkonte që Hona të kryente, procedura shtesë për të ofruar një nivel më të lartë sigurie në lidhje me vlefshmërinë e shifrave të përfshira në pasqyrat financiare.

Në krahasim, në një auditim, ofrohet një nivel i lartë sigurie. Auditorët japin një opinion të një sigurie pozitive, por jo absolute. Përdoruesi sigurohet se shifrat janë pa anomali materiale dhe se auditori ka bazuar opinionin mbi procedurat e detajuara.

Detyra 3

Ju jeni një mbikëqyrës auditimi në firmën Eli Shpk dhe po planifikoni auditimin e Dardhat Shpk për vitin që përfundon më 30 shtator 2020. Kompania zhvillon dhe prodhon produkte të specializuara të bojës dhe ka qenë një klient i firmës suaj prej disa vitesh. Menaxheri i auditimit ka marrë pjesë në një takim planifikimi me drejtorin financiar dhe ju ka ofruar shënimet e mëposhtme të takimit dhe ekstraktet e pasqyrave financiare. Juve ju është kërkuar nga menaxheri i auditimit të ndërmerrni procedura paraprake analitike duke përdorur ekstraktet e pasqyrave financiare.

Shënime të takimit të planifikimit:

Gjatë vitit Dardhat Shpk ka shpenzuar 0.9 milion dollarë, të cilat përfshihen në pasuritë e patrupëzuara, për zhvillimin e linjave të reja të produkteve, disa prej të cilave janë në fazat e hershme të ciklit të tyre të zhvillimit. Gjithashtu, duke qenë se kompania po kërkon të zgjerojë prodhimin, gjatë vitit bleu dhe instaloi një linjë të re prodhimi. Të gjitha kostot, të shkaktuara në blerjen dhe instalimin e asaj pasurie, janë përfshirë brenda pronës, impianteve dhe pajisjeve. Këto kosto të kapitalizuara përfshijnë çmimin e blerjes prej 2.2 milion dollarë, kostot e instalimit prej 0.4 milion dollarë dhe një plan servisimi dhe mirëmbajtjeje pesë-vjeçare që kushton 0.5 milion dollarë. Për të financuar projektet e zhvillimit dhe linjën e re të prodhimit, kompania ka marrë 4 milionë dollarë hua nga banka, e cila do të shlyhet me këste gjatë tetë viteve dhe ka një normë interesi prej 5%. Zhvillimi i produkteve të reja dhe zgjerimi i prodhimit është i rëndësishëm pasi kompania synon të ndërmarrë një listim në bursë në 12 muajt e ardhshëm. Kompania filloi një sërë iniciativash gjatë vitit për të rritur të hyrat. Ajo ofroi kushte të zgjeruara kredie për klientët e saj me kusht që të rriteshin sasitë e porosive të tyre të shitjeve. Përveç kësaj, Dardhat bëri një njoftim në tetor 2019 për 'premtimin e saj të çmimit': se do të përputhej me çmimet e çdo konkurrenti për produkte të ngjashme të blera. Klientëve që janë në gjendje të vërtetojnë se mund t'i blejnë produktet më lirë diku tjetër, u kërkohet të kërkojnë diferencën nga Dardhat, brenda një muaji nga data e blerjes së mallrave, nëpërmjet faqes së saj të internetit. Kompania synon të përfshijë një detyrim rimbursimi prej 0.25 milion dollarë, i cili bazohet në nivelin mujor të pretendimeve të deritanishme, në draft pasqyrat financiare. Drejtori i financës informoi menaxherin e auditimit se në qershor 2020 u shfaq një problem në lidhje me përzierjen e materialeve brenda procesit të prodhimit për një linjë të veçantë produkti. Një numër i këtyre produkteve të bojës me defekt ishin shitur tashmë dhe problemi u identifikua pas një numri ankesash nga klientët për konsistencën e bojës jo korrekte. Si masë paraprake, shitjet e mëtejshme janë ndaluar dhe një tërheqje e produktit është iniciuar për cilindo nga këto produkte specifike bojësh të shitura që nga qershori. Menaxhmenti po heton nëse konsistenca e bojës së produkteve me defekt mund të korrigjohet dhe më pas të shitet.

Ekstrakte të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 30 shtator:

	Parashikimi	Aktuale
	2020	2019
	'000	'000
Të hyrat	19,850	16,990
KMSH	(12,440)	(10,800)
Fitimi bruto	7,410	6,190
Stoqet	1,850	1,330
Të arkëtueshmet	2,750	1,780
Banka	(810)	560
Të pagueshmet	1,970	1,190

Kërkohe:

- (a) Shpjegoni pse procedurat analitike përdoren gjatë TRI fazat e auditimit. (3 pikë)
- (b) Llogaritni TRE koeficient, për TË DY vitet, të cilat do t'ju ndihmojnë në planifikimin e auditimit të Dardhat. (3 pikë)
- (c) Duke përdorur informacionin e dhënë dhe koeficientët e llogaritur, përshkruani TETË rreziqet e auditimit dhe shpjegoni përgjigjen e auditorit për secilin rrezik në planifikimin e auditimit të Dardhat. Shënim: Përgatitni përgjigjen tuaj duke përdorur dy kolona të titulluara respektivisht *Rreziku i auditimit* dhe *Përgjigja e auditorit*. (16 pikë)
- (d) Përshkruani procedurat thelbësore që auditori duhet të kryejë në lidhje me produktet e bojës me defekt të mbajtura në stoqe në fund të vitit. (3 pikë)
- (e) Përshkruani procedurat thelbësore që auditori duhet të kryejë për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në lidhje me të hyrat e Dardhat. (5 pikë)

[Gjithsej: 30 pikë]

Zgjidhja

(a) Procedurat analitike

Procedurat analitike mund të përdoren në të gjitha fazat e një auditimi, megjithatë, SNA 315 Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale nëpërmjet të kuptuarit të entitetit dhe mjedisit të tij dhe ISA 520 Procedurat analitike identifikojnë tre faza të veçanta. Gjatë fazës së planifikimit, procedurat analitike duhet të përdoren si procedura të vlerësimit të rrezikut për të ndihmuar audituesin të kuptojë entitetin dhe të vlerësojë rrezikun e anomalive materiale. Gjatë auditimit përfundimtar, procedurat analitike mund të përdoren për të marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Procedurat thelbësore mund të jenë ose teste të detajeve ose procedura analitike thelbësore. Në fazën përfundimtare të rishikimit, audituesi duhet të hartojë dhe të kryejë procedura analitike të cilat i ndihmojnë kur të krijojnë një përfundim të përgjithshëm nëse pasqyrat financiare janë në përputhje me të kuptuarit e auditorit për entitetin.

(b) Koeficientët

	2020	2019
Marzha bruto	$7,410/19,850 = 37.3\%$	$6,190/16,990 = 36.4\%$
Periudha e mbajtjes së stoqeve	$1,850/12,440 * 365 = 54$ ditë	$1,330/10,800 * 365 = 45$ ditë
Qarkullimi i stoqeve	$12,440/1,850 = 6.7$	$10,800/1,330 = 8.1$
Periudha e mbledhjes së të arkëtueshmeve	$2,750/19,850 * 365 = 51$ ditë	$1,780/16,990 * 365 = 38$ ditë
Periudha e pagesës së të pagueshmeve	$1,970/12,440 * 365 = 58$ ditë	$1,190/10,800 * 365 = 40$ ditë
Koeficienti qarkullues	$4,600/(1,970 + 810) = 1.65$	$3,670/1,190 = 3.08$
Koeficienti i shpejtësisë	$2,750/(1,970 + 810) = 0.99$	$(3,670 - 1,330)/1,190 = 1.97$

(c) Rreziqet e auditimit dhe përgjigja e auditorit

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditimit
<p>Gjatë vitit, Dardhat ka shpenzuar 0.9 milion Euro për zhvillimin e linjave të reja të produkteve, disa prej të cilave janë në fazat e hershme të ciklit të tyre të zhvillimit. Ky shpenzim klasifikohet si hulumentim dhe zhvillim sipas SNK 38 Pasuritë e patrupëzuara. Standardi kërkon që kostot e hulumentimit të shpenzohen në fitim ose humbje dhe vetëm kostot e zhvillimit të kapitalizohen si një pasuri e patrupëzuar. Kompania i ka përfshirë të gjitha këto shpenzime si një pasuri e patrupëzuar. Nëse kostot e hulumentimit janë klasifikuar gabimisht si shpenzime zhvillimi, ekziston rreziku që pasuritë e patrupëzuara të mbivlerësohen dhe shpenzimet të nënvlerësohen.</p>	<p>Merrni një listë të shpenzimeve dhe verifikoni që ato lidhen me zhvillimin e produkteve të reja. Rishikoni dokumentacionin e shpenzimeve për të përcaktuar nëse kostot lidhen me fazën e hulumentimit ose zhvillimit. Diskutoni trajtimin kontabël me drejtorin financiar dhe sigurohuni që është në përputhje me SNK 38.</p>
<p>Dardhat bleu dhe instaloi një linjë të re prodhimi. Kostot përfshijnë çmimin e blerjes (2.2 milion Euro), kostot e instalimit (0.4 milion Euro) dhe një plan servisimi dhe mirëmbajtjeje pesëvjeçare (0.5 milion Euro). Sipas SNK 16 Pronat, impiantet dhe pajisjet, kostoja e një pasurie përfshin vetëm çmimin e blerjes së tij dhe kostot që i atribuohen drejtpërdrejt. SNK 16 nuk lejon që kostot e servisimit dhe mirëmbajtjes të kapitalizohen si pjesë e kostos së një pasurie joqarkulluese, pasi ato nuk lidhen drejtpërdrejt me koston e sjelljes së pasurisë në gjendjen e tij të punës. Kostot e servisit lidhen me një periudhë pesëvjeçare dhe kështu duhet të ngarkohen në fitim ose humbje gjatë kësaj kohe. Pjesa paraprake përfaqëson një parapagim për pesë vjet; ndërsa shërbimet merren, pjesa përkatëse e koston duhet të ngarkohet me fitimin ose humbjen. Nëse shërbimi për 2020 është kryer, atëherë 0.1 milion Euro (0.5 milion Euro/5) duhet të ngarkohet në fitim ose humbje. Prandaj, pronat, objektet dhe pajisjet (PPE) dhe fitimet janë të mbivlerësuara dhe parapagimet janë të nënvlerësuara.</p>	<p>Rishikoni dokumentacionin e blerjes për linjën e re të prodhimit për të konfirmuar koston e saktë të servisimit dhe se lidhet me një periudhë pesëvjeçare. Diskutoni trajtimin kontabël me drejtorin financiar dhe nivelin e çdo rregullimi të nevojshëm për të siguruar që trajtimi është në përputhje me SNK 16.</p>
<p>Kompania ka marrë hua 4 milionë Euro nga banka nëpërmjet një kredie tetëvjeçare. Kjo hua duhet të ndahet në mënyrë të saktë midis detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata në mënyrë që të sigurohet shpallje e saktë.</p>	<p>Gjatë auditimit, ekipi do të duhet të konfirmojë se financimi i huasë prej 4 milionë Eurosh është marrë. Përveç kësaj, ndarja midis detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata dhe informacionet shpjeguese për këtë kredi duhet të rishikohen në detaje për të siguruar përputhjen me standardet përkatëse të</p>

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditimit
	kontabilitetit dhe legjislacionin vendas. Detajet e sigurisë/garancisë duhet të bien dakord me letrën e konfirmimit të bankës.
Ndërsa niveli i borxhit është rritur, duhet të ketë kosto shtesë financimi pasi kredia ka një normë interesi prej 5%. Ekziston rreziku që kjo të jetë anashkaluar nga pasqyra e fitimit ose humbjes që çon në nënvlerësim të kostove financiare dhe fitim të mbivlerësuar.	Kostot e financimit duhet të rillogariten dhe çdo rritje të bihet dakord me dokumentacionin e kredisë për konfirmimin e normës së interesit 5%. Pagesat e interesit duhet të rakordohen për librin e parave të gatshme dhe pasqyrat bankare për të konfirmuar se shuma është paguar dhe për këtë arsye nuk është e pagueshme në fund të vitit.
Dardhat synon të ndër marrë një listim në bursë në 12 muajt e ardhshëm. Për të maksimizuar suksesin e listimit të mundshëm, Dardhat do të duhet të paraqesë pasqyrat financiare që tregojnë pozicionin dhe performancën më të mirë të mundshme. Prandaj, drejtorët kanë një nxitje për të manipuluar pasqyrat financiare, duke mbivlerësuar të ardhurat, fitimet dhe pasuritë.	Firma e auditimit duhet të sigurojë që ka një ekip auditimi me përvojë të përshtatshme. Gjithashtu, duhet t'u jepet kohë e mjaftueshme anëtarëve të ekipit për të kuptuar kompaninë dhe rreziqet e rëndësishme të mbivlerësimit të të ardhurave, fitimeve dhe pasurive, duke përfshirë pjesëmarrjen në një takim të ekipit të auditimit. Ekipi duhet të ruajë skepticizmin profesional dhe të jetë vigjilent ndaj rrezikut të shtuar të manipulimit. Vlerësimet dhe gjykimet e rëndësishme duhet të rishikohen me kujdes duke konsideruar rrezikut të keqdeklarimit
Periudha e arkëtimit të të arkëtueshmeve është rritur nga 38 në 51 ditë dhe menaxhmenti ka zgjatur kushtet e kredisë për klientët me kusht që të rriten sasitë e porosive të shitjes. Rritja e ditëve të arkëtueshme mund të jetë vetëm për shkak të këtyre kushteve të rritura të kredisë. Megjithatë, mund të jetë edhe për shkak të një rreziku të shtuar mbi rikuperimin e të arkëtueshmeve pasi ato mund të mbivlerësohen dhe shpenzimet të nënvlerësohen.	Rishikoni dhe testoni kontrollet rreth mënyrës se si Dardhat identifikon saldot e të arkëtueshmeve që mund të mos jenë të rikuperueshme dhe procedurat rreth kontrollit të kredisë për të siguruar që ato funksionojnë në mënyrë efektive. Testimi pas përfundimit të vitit të arkëtimit të parave të gatshme dhe një rishikim i librit të llogarive të arkëtueshme të moshuara për të vlerësuar pohimin e vlerësimit. Konsideroni gjithashtu përshtatshmërinë e çdo provizionit për të arkëtueshmet.
Këtë vit kompania bëri një 'premtim çmimi' për të përputhur çmimin e konkurrentëve të saj për produkte të ngjashme. Klientët mund të kërkojnë diferencën nga kompania për një muaj pas datës së blerjes së mallrave. Kompania duhet të llogarisë për premtimin e çmimit në përputhje me SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët. Duke qenë se kompanisë mund t'i kërkohej të sigurojë një rimbursim, shuma e parashikuar e rimbursimit nuk duhet të njihet fillimisht si e ardhur, por në vend të kësaj si një detyrim rimbursimi derisa të përfundojë periudha e premtimit të çmimit njëmuajor. Kjo është një	Diskutoni me menaxhmentin bazën e detyrimit të rimbursimit prej 0.25 milion Euro dhe merrni dokumentacionin mbështetës për të konfirmuar arsyeshmërinë e supozimeve dhe llogaritjeve.

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditimit
<p>fushë shumë subjektive, me shumë gjykime të kërkuara në lidhje me nivelin e rimbursimit të mundshëm. Duke qenë se ky është një detyrim i ri, drejtorët mund të mos e kenë llogaritur saktë këtë shumë duke rezultuar në të ardhura të mbivlerësuara, fitime dhe detyrime të nënvlerësuara/të mbivlerësuara.</p>	
<p>Dardhat ka ndalur shitjet e mëtejshme të një prej produkteve të saj të bojës dhe ka filluar një tërheqje e produktit për çdo malli të shitur që nga qershori. Kjo tërheqje e produktit do të rezultojë që Dardhat t'u paguajë rimbursimet klientëve. Shitjet do të duhet të shlyhen nga pasqyrat financiare të 2020 dhe të njihet një detyrim rimbursimi. Gjithashtu, stoqet do të duhet të rikthehen, megjithëse me një vlerë ndoshta me të ulët. Dështimi për të llogaritur saktë këtë mund të rezultojë në të ardhura të mbivlerësuara, detyrime të nënvlerësuara dhe stoqe që përmbajnë anomali.</p>	<p>Rishikoni listën e shitjeve të produktit të bojës të bëra midis qershorit dhe datës së tërheqjes, bini dakord që shitjet janë hequr nga të ardhurat dhe stoqet janë përfshirë. Nëse rimbursimet nuk janë paguar para fundit të vitit, rishikoni draft pasqyrat financiare për të konfirmuar se ato janë përfshirë në detyrimet afatshkurta.</p>
<p>Kompania mban në stoqe një numër produktesh bojërash të dëmtuara dhe në përgjithësi periudha e mbajtjes së stoqeve është rritur nga 45 ditë në 54 ditë. Për shkak të problemit me konsistencën e bojës, cilësia e këtyre produkteve është e diskutueshme dhe menaxhmenti është duke hetuar nëse këto produkte mund të korrigjohen. Ekziston rreziku që këto stoqe mund të mbivlerësohen pasi vlera e tyre neto e realizueshme mund të jetë nën kosto.</p>	<p>Diskutoni me drejtorin e financës nëse do t'i bëhet ndonjë provizionim i këtij produkti dhe çfarë modifikimesh, nëse ka, do të kërkojen për të korrigjuar cilësinë e produktit. Testimi duhet të ndërmerret për të konfirmuar koston dhe VNR-në e produkteve të bojës së prekur që mbahen në stoqe dhe që mallrat të vlerësohen në mënyrë të saktë në bazë të rresht pas rreshti.</p>
<p>Të ardhurat janë rritur me 16.8% në vit; dhe marzhi bruto është rritur pak nga 36.4% në 37.3%. Kjo është një rritje e konsiderueshme e të ardhurave dhe, së bashku me rritjen e marzhit bruto, mund të lidhet me rritjen e periudhës së kreditimit dhe promovimin e premtimit të çmimit ose mund të jetë për shkak të një mbivlerësimi të të ardhurave.</p>	<p>Gjatë auditimit do të merret një listë e detajuar e shitjeve, do të diskutohet me menaxhmentin dhe do të testohet për të kuptuar rritjen e shitjeve. Gjithashtu duhet të ndërmerren teste të shtuara për të verifikuar që të ardhurat janë regjistruar në periudhën e duhur dhe nuk janë të mbivlerësuara.</p>
<p>Periudha e pagesës së detyrimeve është rritur nga 40 në 58 ditë. Koeficienti qarkullues ka rënë nga 3.08 në 1.65. Koeficienti i shpejtësisë është ulur gjithashtu nga 1.97 në 0.99. Për më tepër, gjendja bankare ka lëvizur nga 0.56 milion Euro në një mbiterheqje prej 0.81 milion Euro. Këta janë të gjithë tregues se kompania mund të jetë duke përjetuar një reduktim të rrjedhës së parasë, gjë që mund të rezultojë në vështirësi ose pasiguri lidhur me vijimësinë. Këto pasiguri mund të mos</p>	<p>Testimi i detajuar i vijimësisë që do të kryhet gjatë auditimit, duke përfshirë rishikimin e parashikimeve të rrejdhave të parasë dhe supozimet themelore. Këto duhet të diskutohen me menaxhmentin për të siguruar që baza e vijimësisë është e arsyeshme.</p>

Rreziku i auditimit	Përgjigja e auditimit
shpalosen në mënyrë adekuatë në pasqyrat financiare.	

(d) Stoqet e dëmtuara

- Merrni një listë të mallrave të dëmtuara të mbajtura në inventar dhe të kthyer nga klientët dhe kryeni veprimet matematikore për të konfirmuar saktësinë e tij.
- Nga lista, përputhni sasi të mallrave të dëmtuara të prodhuara që nga qershori në të dhënat e prodhimit; dhe përputhni me regjistrimet e shitjeve të sasive të shitura.
- Rakordoni, mbi bazën e mostrës, për kthimet nga klientët sipas listës në dokumentacionin e kthimit të shitjeve për të konfirmuar ekzistencën e sasive të kthimit.
- Diskutoni me menaxhmentin statusin aktual të planeve të tyre për këtë linjë produkti dhe nëse ata janë në gjendje të korrigjojnë dëmin dhe më pas t'i shesin mallrat. Nëse po, rishikoni kostot e korrigjimit me dokumentacionit mbështetës.
- Nëse stoqet e dëmtuara janë korrigjuar dhe shitur pas fundit të vitit, rakordoni me faturat e shitjes për të vlerësuar VNR në përputhje me koston e re të produktit.
- Përputhni koston e mallrave të dëmtuara me dokumentacionin mbështetës për të konfirmuar koston e lëndës së parë, koston e punës dhe çdo shpenzim të përgjithshëm që i atribuohet koston.
- Diskutoni me menaxhmentin nëse mallrat janë provizionuar; nëse po, ndiqni shënimin deri te vlerësimi i stoqeve për ta konfirmuar.
- Inspektoni procesverbalet mujore të mbledhjes së bordit nga qershori 2020 e tutje për të marrë informacion të mëtejshëm në lidhje me bojën me defekt dhe vlerën e mundshme të rishitjes së saj.

(e) Të ardhurat

- Krahasoni nivelin e përgjithshëm të të ardhurave me vitet e mëparshme dhe buxhetin për vitin dhe hulumtoni çdo luhajtje të rëndësishme.
- Kryeni një vërtetim në llogaritjen totale për të ardhurat, duke krijuar një pritshmëri të çmimit mesatar për produktet kryesore të bojës shumëzuar me vëllimet e rritura të shitjeve për këtë vit. Kjo pritshmëri duhet të krahasohet me të ardhurat aktuale dhe çdo luhajtje e rëndësishme duhet të hetohet.
- Merrni një listë shitjesh për vitin të ndarë në kategoritë kryesore të produkteve dhe krahasojeni këtë me listën e vitit të kaluar dhe për çdo lëvizje të pazakontë, diskutoni me menaxhmentin.
- Llogaritni marzhin përfundimtar të fitimit bruto për Dardhat dhe krahasoni këtë me vitin e kaluar dhe hetoni çdo luhajtje të rëndësishme.
- Zgjidhni një mostër të faturave të shitjes për klientët dhe përputhni çmimet e shitjes përsëri në listën e çmimeve ose me të dhënat nga skedari kryesor i klientit për të siguruar saktësinë e faturave.
- Për një mostër të faturave, rillogaritni totalin e faturave duke përfshirë zbritjet dhe TVSH.
- Zgjidhni një mostër të notave të kreditit, gjurmoni deri në faturën origjinale dhe sigurohuni që fatura të jetë hequr saktë nga shitjet.
- Zgjidhni një mostër të porosive të klientëve dhe përputhni ato me fletëdërgesat dhe faturat e shitjeve deri në përfshirjen në librin e shitjeve dhe llogaritë e librit të përgjithshëm të të ardhurave për të siguruar plotësinë e të ardhurave.

- Zgjidhni një mostër të fletëdërgesave para dhe pas fundit të vitit dhe ndiqni këto deri te faturat e shitjeve në periudhën e duhur kontabël për t'u siguruar që prerja është zbatuar saktë.
- Për shitjet e bëra sipas premtimit të çmimit, krahasoni nivelin e pretendimeve të bëra deri më sot me detyrimin e njohur të rimbursimit dhe vlerësoni nëse është i arsyeshëm.
- Për një mostër të faturave të shitjes të lëshuara midis qershorit dhe tërheqjes së produktit, gjurmoni në shënimet e mëvonshme të kreditit për të konfirmuar që shitja është hequr nga të ardhurat.

Detyra 4

(a) Ju jeni përgjegjës për auditimin e Denisi Shpk, e cila ka një vit financiar të përfunduar më 31 maj 2021. Partneri i angazhimit të auditimit, Billi, ju dërgoi emailin e mëposhtëm këtë mëngjes:

Për: Menaxheri i auditimit

Nga: Bill Fish, partner i angazhimit të auditimit, Denisi Shpk

Lidhur me: Incident mjedisor

Përshëndetje

Drejtori i financave të Denisi Shpk më thirri dje për të shpjeguar se fatkeqësisht gjatë javëve të fundit, një nga katër fabrikat e saj rrjedhi një sasi të vogël kimikatesh toksike në atmosferë. Punimet e fabrikës u ndërprejnë menjëherë dhe është marrë vendimi për mbylljen e përhershme të kantierit. Megjithatë kjo është një ngjarje e rëndësishme për kompaninë dhe do të rezultojë në zhvendosje dhe disa ristrukturime të operacioneve, ajo nuk konsiderohet të jetë një kërcënim për hipotezën e vijimësisë së kompanisë. Kostot e mbylljes së fabrikës janë vlerësuar të jenë 1.25 milion dollarë, e cila pritet të jetë materiale për pasqyrat financiare dhe është krijuar një provizion në lidhje me këto kosto.

Denisi është e prirur të nxjerrë në pah rekordin e saj të mëparshëm të shkëlqyer në çështjet socio-mjedisore. Menaxhmenti është duke përgatitur një raport që do të publikohet me pasqyrat financiare, i cili do të përshkruajë angazhimin e kompanisë ndaj çështjeve socio-mjedisore dhe do të deklarojë objektivin e saj për të reduktuar dëmin mjedisor të shkaktuar nga operacionet e saj. Raporti do të përmbajë një përzgjedhje objektivash dhe treguesish kryesorë të performancës për të treguar performancën në fusha të tilla si përdorimi i energjisë, konsumi i ujit dhe kënaqësia e punonjësve. Firmës sonë mund t'i kërkohet të japë një raport sigurie mbi treguesit kryesorë të performancës.

Kërkohet:

(i) Rekomandoni procedurat kryesore të auditimit për t'u kryer në lidhje me kostot e mbylljes së fabrikës; dhe (9 pikë)

(ii) Diskutoni vështirësitë në matjen dhe raportimin mbi performancën mjedisore dhe sociale. (6 pikë)

(b) Ju jeni një menaxher i lartë në departamentin e auditimit të Rea-Audit. Ju po rishikoni dy situata që kanë lindur në lidhje me klientët e auditimit, të cilat u diskutuan së fundi në takimin mujor të menaxherëve të auditimit:

GriGri është një klient i rëndësishëm auditimi i cili zhvillon paketa softuerësh. Drejtori i saj menaxhues, Makis, ka kontaktuar një nga partnerët e firmës suaj në lidhje me një mundësi të mundshme biznesi. Propozimi është që GriGri dhe Rea-Audit mund të zhvillojnë së bashku softuerin e kontabilitetit dhe llogaritjes së taksave, dhe se të ardhurat nga shitjet e softuerit do të ndahen në mënyrë të barabartë midis dy firmave. Maksi mendon se klientët e auditimit të Rea-Audit do të ishin një bazë e mirë klientësh për produktin.

Kërkohet:

Identifikoni dhe diskutoni çështjet etike, tregtare dhe të tjera profesionale të ngritura dhe rekomandoni çdo veprim që duhet të ndërmerret në lidhje me:

(a) GriGri; dhe (5 pikë)

[Gjithsej: 20 pikë]

Zgjidhja

(a)

Nga: Menaxheri i auditimit

Për: Partnerin e auditimit

Ceshtja: Denisi

Hyrje

Këto shënime informuese fillimisht do të rekomandojnë procedurat kryesore të auditimit që duhet të kryhen në lidhje me kostot e mbylljes së fabrikës të përfshirë në ndotjen e mjedisit. Do të diskutoj gjithashtu për vështirësitë në matjen dhe raportimin e performancës mjedisore dhe sociale.

(i) Procedurat e rekomanduara të auditimit

- Rishikoni procesverbalet e bordit për diskutimin e mbylljes dhe ristrukturimit, duke vënë në dukje datën kur u mor vendimi për ristrukturimin, i cili duhet të jetë përpara fundit të vitit.
- Merrni çdo plan të detajuar dhe formal në lidhje me mbylljen e fabrikës dhe zhvendosjen e funksionimit të saj, duke shënuar datën e miratimit të planit, e cila duhet të jetë përpara fundit të vitit.
- Diskutoni me menaxhmentin çdo tregues që kompania ka filluar të zbatojë planin përpara fundit të vitit, p.sh. datën e çdo shpalljeje publike, datën kur ajo fabrikë filloi të çmontohej.
- Inspektoni fizikisht fabrikën për dëshmi se çmontimi ka filluar.

Shënim udhëzues: Procedurat e përshkruara më sipër duhet të përcaktojnë nëse ekziston një detyrim konstruktiv në fund të vitit, në të cilin rast është e përshtatshme të njihet një provizion sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente. Nëse nuk ekziston një plan formal i detajuar dhe nuk ka dëshmi se ekziston një pritshmëri e vlefshme që kompania do të kryejë ristrukturimin në fund të vitit, atëherë nuk duhet të njihet asnjë provizion.

- Merrni një listë të kostove prej 1.25 milionë dollarësh të mbylljes dhe rishikoni për të siguruar që janë përfshirë vetëm kostot përkatëse, p.sh. pagesat e tepricës së punonjësve, tarifat e anulimit të qirasë. Kjo është një procedurë e rëndësishme për mbivlerësimin e mundshëm të provizionit.
- Mblidhni listën për saktësinë aritmetike.
- Rakordoni një mostër të kostove përkatëse të përfshira me dokumentacionin mbështetës, p.sh. pagesat e tepricës së punonjësve, tarifat e anulimit të qirasë (nëse ka) për marrëveshjen e qirasë.
- Kërkoni nëse pritet të ketë ndonjë fitim nga shitja e pasurive dhe sigurohuni që nëse po, fitimi nuk është marrë parasysh gjatë matjes së provizionit.

Shënim udhëzues: SNK 37 përshkruan që vetëm kostot e shkaktuara domosdoshmërisht nga ristrukturimi dhe që nuk lidhen me aktivitetet e vazhdueshme të biznesit mund të përfshihen në provizion. Në praktikë kjo do të thotë se mund të përfshihen shumë pak kosto dhe kostot që kanë të bëjnë me zhvendosjen e punonjësve, impiantet dhe pajisjet dhe stoqet, rikualifikimin e stafit, investimet në infrastrukturën e re nuk përfshihen pasi ato lidhen me aktivitetet e vazhdueshme.

- Rishikoni shënimin përkatës në shpalljet e pasqyrave financiare për saktësi dhe mjaftueshmëri, ku provizioni duhet të trajtohet si një klasë numerike më vete dhe të jepet një përshkrim i tij.

Shënim udhëzues: Pikë do të jepen gjithashtu për procedurat që lidhen me përcaktimin nëse mbyllja e fabrikës përbën një operacion të ndërprerë, dhe procedurat që lidhen me çdo kërkesë për shpallje në PF.

(ii) Matja dhe raportimi mbi performancën sociale dhe mjedisore

Shumë kompani përpiqen të masin performancën sociale dhe mjedisore duke vendosur objektiva ose tregues kryesorë të performancës (KPI) dhe më pas duke vlerësuar nëse ato janë përmbushur. Rezultatet publikohen shpesh për të mundësuar krahasimin nga viti në vit ose

ndërmjet kompanive. Por mund të jetë e vështirë të matet performanca sociale dhe mjedisore për një sërë arsyesh.

Së pari, objektivat dhe KPI-të nuk janë gjithmonë të përcaktuara saktësisht. Për shembull, Denisi mund të deklarojë një objektiv të reduktimit të dëmit mjedisor të shkaktuar nga operacionet e saj, por kjo është shumë e paqartë. Është e vështirë të matet dhe të krahasohet performanca nëse një objektiv ose KPI nuk bëhet më specifik, për shembull, një objektiv i reduktimit të konsumit të energjisë elektrike me 5% në vit.

Së dyti, objektivat dhe KPI-të mund të jenë të vështira ose të pamundura për t'u llogaritur, me KPI-në e planifikuar të Denisi për kënaqësinë e punonjësve që është një shembull i mirë. Kjo është një çështje shumë subjektive, dhe ndërsa ka metoda që mund të përdoren për të vlerësuar nivelet e kënaqësisë së punonjësve, nëse kjo mund të rezultojë në një statistikë kuptimplotë është e diskutueshme.

Së treti, sistemet dhe kontrollet shpesh nuk vendosen mjaft mirë për të lejuar matje të sakta dhe matja e çështjeve socio-mjedisore mund të mos bazohet në prova të besueshme. Në rastin e Denisi, mund të mos jetë e mundur të përcaktohet sasia e kimikateve toksike që ka rrjedhur nga fabrika.

Së fundi, është e vështirë të krahasohen këto objektiva dhe KPI ndërmjet kompanive, pasi ato nuk janë të përcaktuara në mënyrë strikte, kështu që çdo kompani do të vendosë objektivin e saj. Gjithashtu do të jetë e vështirë të bëhen krahasime vit pas viti për të njëjtën kompani, pasi objektivat mund të ndryshojnë në varësi të aktiviteteve të biznesit. Për shembull, nëse Denisi do të zgjeronte funksionimin e saj, përdorimi i energjisë dhe ujit do të rritej, duke e bërë performancën e saj në çështjet mjedisore të duken më keq. Përdoruesit do të duhet të kuptojnë kontekstin në mënyrë që të vlerësojnë siç duhet pse një objektiv nuk ishte arritur.

Konkluzioni

Këto shënime informuese kanë treguar se incidenti mjedisor në Denisi do të ketë një ndikim në auditimin tonë në atë që procedurat e detajuara të auditimit do të duhet të kryhen për të përfutur dëshmi në lidhje me nëse një provizion për kostot e mbylljes duhet të njihet apo jo, dhe nëse po, matja e tij. Për më tepër, synimi i Denisi për të publikuar objektivat socio-mjedisore dhe KPI-të është i lavdërueshëm, por do të jetë e vështirë për menaxhmentin të masë dhe të raportojë për këto çështje për shkak të natyrës së tyre shpesh subjektive.

(b) Sipërmarrja e biznesit e propozuar nga drejtori menaxhues i GriGri, ndonëse potencialisht fitimprurëse për firmën e auditimit, do të krijonte kërcënime të rëndësishme për objektivitetin. Një interes financiar në një sipërmarrje të përbashkët si ajo që propozohet është një shembull i një marrëveshjeje të ngushtë biznesi të dhënë në Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë të IFAC.

Sipas Kodit, një marrëdhënie e ngushtë biznesi midis një firme auditimi dhe klientit të auditimit ose menaxhmentit të saj, e cila lind nga një marrëdhënie tregtare ose interes i përbashkët financiar, mund të krijojë kërcënime për interesin vetjak ose frikësimin. Firma e auditimit duhet të ruajë pavarësinë dhe perceptimi i pavarësisë do të ndikohet kur firma e auditimit dhe klienti shihet se punojnë së bashku për përfitime të ndërsjella financiare.

Me përjashtim të rastit kur interesi financiar është jomaterial dhe marrëdhënia e biznesit është e parëndësishme për firmën dhe klientin ose menaxhmentin e saj, kërcënimi i krijuar nga sipërmarrja e përbashkët do të ishte aq i rëndësishëm sa që asnjë masë mbrojtëse nuk mund të reduktojë kërcënimin ndaj objektivitetit në një nivel të pranueshëm. Prandaj, përveç nëse interesi financiar është jomaterial dhe marrëdhënia e biznesit është e parëndësishme, marrëdhënia e biznesit nuk duhet të lidhet.

Do të ngriheshin gjithashtu çështje etike nëse firma e auditimit do t'u shiste paketat e softuerit klientëve të auditimit. Së pari, do të kishte një kërcënim të interesit vetjak, pasi firma e auditimit do të përfitonte financiarisht nga të ardhurat e krijuara nga këto shitje. Duhet të bëhet shpalosje e plotë klientëve në mënyrë që ata të bëhen të vetëdijshëm për përfitimin financiar që firma e auditimit do të merrte nga shitja.

Së dyti, do të kishte një kërcënim vetë-rishikimi, pasi gjatë kryerjes së auditimit, ekipi i auditimit do të vlerësonte softuerin e kontabilitetit që vetë ia kishte shitur klientit të auditimit dhe do të kontrollonte shifrat tatimore të krijuara nga softueri. Është e vështirë të shihet se si ky kërcënim mund të reduktohet në një nivel të pranueshëm pasi softveri i kontabilitetit dhe taksave do të ishte thelbësor për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Së treti, duke rekomanduar softuerin për klientët e auditimit, mund të perceptohet se firma e auditimit po ofron një shërbim jo auditues duke u përfshirë në llogaritjet tatimore dhe duke ofruar shërbime të sistemeve të TI-së. Ofrimi i shërbimeve jo audituese krijon disa kërcënime për objektivitetin, duke përfshirë një perceptim të marrjes së përgjegjësive të menaxhmentit. Rreziqet rriten për klientët e auditimit që janë subjekte me interes publik, për shembull, firma e auditimit nuk duhet të përfshihet në llogaritjet tatimore për klientë të tillë sipas Kodit të IFAC.

Nëse ka marrë parasysh kërcënimet etike të diskutuara më sipër, firma e auditimit ende dëshiron të ndjekë marrëveshjen e biznesit, ata duhet të pushojnë së vepruari si auditorë të GriGri me efekt të menjëhershëm. Të ardhurat e humbura nga tarifa e auditimit të GriGri duhet gjithashtu të merren parasysh, pasi ajo është një klient 'i rëndësishëm' i firmës.

Përfitimet e mundshme tregtare të sipërmarrjes së biznesit duhet të konsiderohen me kujdes, pasi mund të ketë pak kërkesë për produktin e sugjeruar, veçanërisht pasi shumë paketa softuerësh të këtij lloji janë tashmë në treg. Gjithashtu, duhet parë edhe cilësia e softuerit të zhvilluar, pasi nëse auditori rekomandon produkte inferiore, ata do të humbasin klientët dhe mund të përballen me publicitet të keq.

Së fundi, nëse auditori vendos të vazhdojë me sipërmarrjen e përbashkët, partnerët do të duhet të konsiderojnë nëse një diversifikim i tillë larg aktivitetit bazë të firmës do të ishte i këshillueshëm. Partnerët mund të kenë pak përvojë në një biznes të tillë dhe mund të jetë më mirë që firma të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve të auditimit dhe sigurisë.